LIGJ
Nr. 10 335, datë 14.10.2010

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES SË FINANCIMIT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMISIONIT TË KOMUNITETEVE EUROPIANE "PËR PROGRAMIN E FINANCIMIT TË PJESËMARRJES SË SHQIPËRISË NË PROGRAMET TRANSNACIONALE ERDF TË OBJEKTIVIT TË BASHKËPUNIMIT TERRITORIAL EUROPIAN "EUROPA JUGLINDORE DHE MESDHEU" TË INSTRUMENTIT TË NDIHMËS SË PARAADERIMIT (IPA), KOMPONENTI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR PËR VITIN 2009""

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja e financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane "Për programin e financimit të pjesëmarrjes së Shqipërisë në programet transnacionale ERDF të objektivit të bashkëpunimit territorial europian "Europa Juglindore dhe Mesdheu" të Instrumentit të Ndihmës së Paraaderimit (IPA), komponenti i bashkëpunimit ndërkufitar për vitin 2009"".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6741, datë 21.10.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE FINANCIMI
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMISIONIT TË KOMUNITETEVE EUROPIANE MBI PROGRAMIN E FINANCIMIT TË PJESËMARRJES SË SHQIPËRISË NË PROGRAMET TRANSNACIONALE ERDF TË BASHKËPUNIMIT TERRITORIAL EUROPIAN "EUROPA JUGLINDORE" DHE "MESDHEU" NËN INSTRUMENTIN E NDIHMËS SË PARAADERIMIT (IPA), KOMPONENTI I BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR, PËR VITIN 2009

(Menaxhimi i centralizuar)

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komisioni i Komuniteteve Europiane, këtej e tutje referuar bashkërisht si "palët", ose individualisht si "vendi përfitues", në rastin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, ose "Komisioni", në rastin e Komisionit të Komuniteteve Europiane,

Duke pasur parasysh se:

a) Më 1 gusht 2006, Këshilli i Bashkimit Europian vendosi me anë të Rregullores (EC) nr.1085/2006 krijimin e një instrumenti të ndihmës së paraaderimit (këtej e tutje: "Rregullorja Kuadër IPA"). Me efekt nga 1 janari 2007, ky instrument përfaqëson bazën e vetme

ligjore për dhënien e asistencës financiare për vendet kandidate (aktualisht Kroacia, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Turqia) dhe vendet kandidate potenciale (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia, duke përfshirë Kosovën sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara) në përpjekjet e tyre për të forcuar reformat politike, ekonomike dhe institucionale me perspektivën për t'u bërë një ditë anëtare të Bashkimit Europian;

b) Më 12 qershor 2007 Komisioni vendosi me anë të Rregullores (EC) nr.718/2007 implementimin e rregullores kuadër IPA, e cila detajon rregullat e aplikueshme të menaxhimit dhe të kontrollit (këtej e tutje: "Rregullorja e zbatimit IPA");

c) Asistenca komunitare, nën instrumentin e asistencës për paraaderim, duhet të vazhdojë t'i mbështesë vendet përfituese në përpjekjet e tyre për të forcuar institucionet demokratike dhe shtetin e së drejtës, të reformojë administratën publike, të ndërmarrë reforma ekonomike, të respektojë të drejtat e njeriut dhe ato të minoriteteve, të promovojë barazinë gjinore, të mbështesë zhvillimin e shoqërisë civile dhe të çojë përpara bashkëpunimin rajonal, si dhe ripajtimin dhe rindërtimin, dhe të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe reduktimin e varfërisë;

Për vendet potenciale kandidate, asistenca komunitare mund të përfshijë përafrimin me *acquis communautaire*, si dhe mbështetjen për projekte në investime që kanë për qëllim në veçanti ndërtimin e kapaciteteve menaxhuese në fushat e zhvillimit rajonal, të burimeve njerëzore dhe atë rural;

d) Palët kanë nënshkruar më 18 tetor 2007 një marrëveshje kuadër që përcakton rregullat e përgjithshme për bashkëpunim dhe implementimin e asistencës komunitare nën instrumentin e ndihmës së paraaderimit;

e) Më datë 20 dhjetor 2007, Komisioni adoptoi programet operacionale ERDF "Europa Juglindore" dhe "Mesdheu", me anë të vendimeve C (2007) 6590 dhe 6578 respektivisht;

f) Më datë 25 gusht 2009, Komisioni miratoi programin mbi financimin e pjesëmarrjes së Shqipërisë në programin ERDF "Europa Juglindore" dhe "Mesdheu" nën instrumentin e ndihmës së paraaderimit, komponenti i bashkëpunimit ndërkufitar, për vitin 2009 (këtej e tutje: "programi"). Ky program do të implementohet nga Komisioni në mënyrë të centralizuar;

g) Për implementimin e këtij programi është e nevojshme që palët të nënshkruajnë një marrëveshje financimi për të përcaktuar kushtet për dhënien e asistencës komunitare, rregullat dhe procedurat që lidhen me disbursimin e kësaj asistence dhe kushteve sipas të cilave do të menaxhohet kjo asistencë,

kanë rënë dakord si më poshtë vijon:

1. PROGRAMI

Komisioni do të kontribuojë me anë të një granti për financimin e programit në vijim, i cili është përcaktuar në aneksin A të kësaj Marrëveshjeje.

Numri i programit: CRIS 2009/021-162

Titulli: Programi i financimit të pjesëmarrjes së Shqipërisë në programet transnacionale ERDF të objektivit të bashkëpunimit territorial europian "Europa Juglindore" dhe "Mesdheu" nën komponentin IPA – Bashkëpunimi ndërkufitar për vitin 2009.

2. ZBATIMI I PROGRAMIT

1. Programi do të zbatohet nga Komisioni në një mënyrë të centralizuar, sipas nenit 53a të Rregullores së Këshillit (EC Euratom) nr.1605/2002 mbi rregulloren financiare të aplikueshme për buxhetin e përgjithshëm të komuniteteve, të ndryshuar sipas Rregullores (EC, Euratom) 1995/2006 të datës 13 dhjetor 2006 (këtej e tutje: "Rregullorja financiare").

2. Programi do të zbatohet në përputhje me dispozitat e marrëveshjes kuadër mbi rregullat për bashkëpunimin që lidhen me asistencën financiare të BE-së për Shqipërinë dhe zbatimin e asistencës, në kuadër të Instrumentit të Paraaderimit (IPA) të arritur ndërmjet palëve në 18 tetor 2007 (këtej e tutje: "Marrëveshja kuadër"), e cila ndodhet në aneksin B të kësaj Marrëveshjeje.

3. STRUKTURAT DHE AUTORITETET PËRGJEGJËSE

1. Përfituesi do të caktojë një koordinator kombëtar IPA, në përputhje me marrëveshjen kuadër, i cili do të veprojë si përfaqësuesi i përfituesit përballë Komisionit. Ai duhet të sigurojë që ekziston një lidhje e fortë ndërmjet Komisionit dhe Përfituesit si për procesin e përgjithshëm të aderimit, ashtu edhe për asistencën e BE-së së paraaderimit nën instrumentin IPA.

2. Koordinatori kombëtar IPA do të jetë gjithashtu përgjegjës për koordinimin e pjesëmarrjes së vendit përfitues në programet përkatëse ndërkufitare, si dhe në programet transnacionale, ndërrajonale ose në programet që përfshijnë vende që lagen nga dete, nën instrumente të tjera të Komunitetit.

3. Vendi përfitues duhet të ngrejë një strukturë operuese përgjegjëse për menaxhimin dhe zbatimin e këtij programi. Kjo strukturë operuese duhet të bashkëpunojë me autoritetin menaxhues të programeve transnacionale “Europa Juglindore” dhe “Mesdheu” dhe do të përfaqësohet në Komitetin e Përbashkët të Monitorimit të këtij programi si anëtare me të drejta të plota.

4. Funksionet dhe përgjegjësitë e strukturës operuese përjashtojnë tenderimin, kontraktimin dhe pagesat, të cilat janë përgjegjësi e Komisionit.

4. FINANCIMI

Financimi për implementimin e kësaj Marrëveshjeje do të jetë si më poshtë:

a) Kontributi i Komunitetit për vitin 2009 për pjesëmarrjen në programet transnacionale ERDF është përcaktuar në një maksimum prej 600 202 €, siç detajohet në aneksin A të kësaj Marrëveshjeje. Megjithatë, pagesa e kontributit të Komunitetit nga Komisioni do të bëhet brenda limiteve të fondeve në dispozicion.

b) Deri në 10% të këtij kontributi mund të përdoret për të bashkëfinancuar kostot operacionale dhe administrative të shpenzuara nga vendi përfitues për implementimin e këtij programi, siç detajohet në aneksin A të kësaj Marrëveshjeje.

5. AFATI PËRFUNDIMTAR PËR NËNSHKRIMIN E KONTRATAVE

1. Kontratat dhe marrëveshjet individuale të cilat zbatojnë këtë Marrëveshje, do të nënshkruhen jo më vonë se dy vjet nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2. Në raste të justifikuara siç duhet, ky afat kontraktimi mund të zgjatet përpara datës së përfundimit të tij për një periudhë maksimale prej tre vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

3. Çdo financim, për të cilin nuk është nënshkruar një kontratë përpara afatit për përfundimin e tij, do të anulohet.

6. AFATI PËR EKZEKUTIMIN E KONTRATAVE

1. Kontratat duhet të zbatohen maksimumi brenda dy vjetësh që nga data e nënshkrimit të tyre.

2. Në raste të justifikuara siç duhet, afati përfundimtar i ekzekutimit të kontratave mund të shtyhet përpara datës së përfundimit të tyre.

7. AFATI I DISBURSIMIT

1. Disbursimi i fondeve duhet të bëhet jo më vonë se një vit nga data e fundit e zbatimit të kontratave.

2. Në raste të justifikuara siç duhet, afati për disbursimin e fondeve mund të shtyhet përpara datës së përfundimit të tyre.

8. TRAJTIMI I TË ARDHURAVE

1. Të ardhurat, në kuadër të IPA-s, përfshijnë të ardhurat e fituara nga një aktivitet gjatë periudhës së bashkëfinancimit IPA, duke filluar që nga shitjet, qiratë, shërbimet/taksat ose fatura të tjera ekuivalente me përjashtim:

a) të të ardhurave të nxjerra gjatë jetës ekonomike të investimeve të bashkëfinancuara në raste të investimit në firma;

b) të të ardhurave të nxjerra brenda kuadrit të një mase inxhinierie financiare, duke përfshirë kapitalin e një sipërmarrjeje dhe fondet hua, fondet e garancisë, kredive;

c) aty ku është e aplikueshme, kontributet nga sektori privat për bashkëfinancimin e aktiviteteve, të cilat do të paraqiten së bashku me kontributin publik në tabelat financiare të programit.

2. Të ardhurat siç përkufizohet në paragrafin 1 më lart, paraqesin të ardhura të cilat duhet të zbriten nga shuma e shpenzimeve të lejueshme për aktivitetin në fjalë. Jo më vonë se mbyllja e programit, këto fatura duhet të zbriten nga shpenzimet e lejueshme përkatëse për aktivitetin në shumën e tyre të plotë ose proporcionale, në varësi të asaj nëse burojnë plotësisht ose pjesërisht nga aktiviteti i bashkëfinancuar.

9. SHPENZIMET E LEJUESHME

1. Shpenzimi në kuadër të këtij programi do të jetë i lejueshëm për kontributin e Komunitetit, nëse ai është kryer aktualisht pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

2. Shpenzimet e mëposhtme nuk do të jenë të lejueshme për kontributin e Komunitetit në kuadër të programit në aneksin A:

a) taksat, duke përfshirë taksën mbi vlerën e shtuar, TVSH-në;

b) detyrimet doganore dhe të importit, ose çdo detyrim tjetër;

c) blerje, dhënie me qira ose me kredi e truallit dhe godinave ekzistuese;

d) gjobat, ndëshkimet financiare dhe shpenzimet për proceset gjyqësore;

e) kostot operacionale;

f) pajisje të dorës së dytë;

g) detyrime bankare, kostot për vënie garancie dhe detyrime të ngjashme;

h) kostot për shkëmbime, detyrime dhe humbje nga këmbimi i monedhave të lidhura me ndonjë komponent specifik të llogarive bankare në euro, si dhe shpenzime të tjera financiare;

i) kontribute në natyrë;

j) interesa mbi borxhe.

3. Me shmangie nga paragrafi 2 më lart, shpenzimet e mëposhtme do të jenë të lejueshme:

a) Taksat mbi vlerën e shtuar, nëse përmbushen kushtet e mëposhtme:

i) nuk janë të rikthyeshme në asnjë lloj mënyre,

ii) është përcaktuar që ato vijnë nga përfituesi i fundit, dhe

iii) janë të identifikuara qartë në projektpropozim.

b) Detyrimet për transaksione financiare transnacionale.

c) Në rast se zbatimi i një aktiviteti kërkon që të hapet një ose më shumë llogari të veçanta, detyrimet bankare për hapjen dhe administrimin e llogarive.

d) Kostot për konsulencë ligjore, kostot noteriale, kostot për ekspertë teknikë ose financiarë, dhe kostot financiare dhe të auditimit, nëse ato janë të lidhura direkt me aktivitetin e bashkëfinancuar dhe janë të nevojshme për përgatitjen ose zbatimin e tij.

e) Kostot e garancisë të siguruara nga një bankë ose institucione të tjetra financiare, në rastet kur një gjë e tillë kërkohet nga legjislacioni kombëtar ose ai i Komunitetit.

f) Shpenzime të përgjithshme të vërtetuara që janë të bazuara në kosto reale të kërkuara gjatë zbatimit të aktivitetit respektiv. Normat bazë të llogaritura mbi bazën e kostove mesatare nuk mund të kalojnë 25% të atyre kostove direkt të një aktiviteti i cili mund të ndikojë nivelin e shpenzimeve të përgjithshme. Përllogaritja duhet të dokumentohet plotësisht dhe të rishikohet periodikisht.

g) Blerja e truallit me një shumë prej deri në 10% të shpenzimeve të lejueshme të projektit në fjalë.

4. Përveç asistencës teknike për programin referuar nenit 94 të rregullores së zbatimit IPA, shpenzimet e mëposhtme të paguara nga autoritetet publike gjatë përgatitjes dhe implementimit të një aktiviteti do të jenë të lejueshme:

a) kostot e shërbimeve të specializuara të ofruara nga një autoritet publik që është i ndryshëm nga përfituesi i fundit gjatë përgatitjes ose implementimit të një aktiviteti;

b) kostot për sigurimin e shërbimeve që lidhen me përgatitjen dhe implementimin e një aktiviteti të ofruar nga një autoritetet publik, i cili është vetë përfituesi i fundit që kryen një aktivitet për llogari të tij pa kërkuar ofrues shërbimesh të tjerë, nëse ato janë kosto shtesë dhe lidhen ose me shpenzime të paguara aktualisht, ose direkt për aktivitetin e bashkëfinancuar.

Autoritetet publike respektive duhet ose t'ua ngarkojnë kostot e referuara në pikën (a) të këtij paragrafi përfituesve të fundit ose t'i certifikojnë këto kosto në bazë të dokumenteve që dëshmojnë se kanë të njëjtën vlerë, të cilat bëjnë të mundur identifikimin e kostove reale të paguara nga ai autoritet për atë projekt.

Kostot e referuara në pikën (b) të këtij paragrafi duhet të jenë të certifikuara me anë të dokumenteve të cilat bëjnë të mundur identifikimin e kostove reale të paguara nga autoriteti publik respektiv për atë aktivitet.

5. Duke respektuar rregullat në paragrafët 1 dhe 4, rregulla të mëtejshme mbi shpenzimet e lejueshme mund të përcaktohen në programet transnacionale ERDF.

10. RUAJTJA E DOKUMENTEVE

1. Të gjitha dokumentet që lidhen me programin në aneksin A duhet të ruhen të paktën për pesë vjet që nga data në të cilën Parlamenti Europian mbyll vitin buxhetor të cilit i përket dokumenti.

2. Në rast se programi në aneksin A nuk është mbyllur përfundimisht brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 1 më lart, dokumentet e lidhura me të duhet të mbahen deri në fund të vitit i cili pason vitin në të cilin programi në aneksin A është mbyllur.

11. HAPAT PËR DECENTRALIZIMIN PA KONTROLLE EX-ANTE

1. Vendi përfitues duhet të përcaktojë një plan të detajuar me etapa indikative dhe limite kohore për të arritur decentralizimin me kontrolle *ex ante* nga Komisioni. Përveç kësaj, vendi përfitues duhet të hartojë një plan indikativ për të arritur decentralizimin pa kontrolle *ex ante* nga Komisioni.

2. Komisioni duhet të monitorojë zbatimin e planeve të përmendura në paragrafin 1, dhe të marrë parasysh rezultatet e arritura nga vendi përfitues në këtë kontekst, në veçanti në sigurimin e asistencës. Plani për të arritur decentralizimin pa kontrolle *ex ante* mund t'i referohet heqjes dorë gradualisht nga tipet e ndryshme të kontrolleve *ex-ante.*

3. Vendi përfitues duhet të mbajë të informuar rregullisht Komisionin mbi progresin e arritur në zbatimin e këtij plani.

12. INTERPRETIMI

1. Në rastin kur një dispozitë konkrete e kësaj Marrëveshjeje shprehet ndryshe, termat e kësaj dispozite duhet të ruajnë të njëjtin kuptim me termat e dispozitave të rregullores kuadër IPA dhe rregullores së zbatimit IPA.

2. Në rastin kur një dispozitë konkrete e kësaj Marrëveshjeje shprehet ndryshe, referencat duhet t'i bëhen marrëveshjes së ndryshuar, plotësuar apo zëvendësuar herë pas here.

3. Çdo referencë ndaj rregulloreve të Këshillit apo Komisionit janë bërë ndaj versionit të tyre siç është treguar. Nëse kërkohen modifikime të këtyre rregulloreve, duhet të zhvendosen në këtë Marrëveshje me anë të ndryshimeve.

4. Titujt në këtë Marrëveshje nuk kanë domethënie ligjore dhe nuk ndikojnë interpretimin e saj.

13. PAVLEFSHMËRIA E PJESSHME DHE BOSHLLËQET E PAQËLLIMSHME

1. Nëse një dispozitë e kësaj Marrëveshjeje është ose bëhet e pavlefshme ose kjo Marrëveshje përmban boshllëqe të paqëllimshme, kjo nuk do të ndikojë vlefshmërinë e dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje. Palët do të zëvendësojnë çdo dispozitë të pavlefshme me një dispozitë të vlefshme, e cila është shumë e ngjashme me qëllimin dhe objektivin e dispozitës së pavlefshme.

2. Palët do të mbushin çdo boshllëk të paqëllimshëm nëpërmjet një dispozite e cila i përshtatet sa më mirë qëllimit dhe objektivit të kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me rregulloren kuadër IPA dhe rregulloren e zbatimit IPA.

14. RISHIKIMI DHE NDRYSHIMI

1. Zbatimi i kësaj Marrëveshjeje do të jetë subjekt i rishikimeve periodike në kohë të rëna dakord ndërmjet palëve.

2. Çdo ndryshim, për të cilin është rënë dakord ndërmjet palëve, do të jetë me shkrim dhe do të jetë pjesë e kësaj Marrëveshjeje. Ndryshime të tilla do të hyjnë në fuqi, pasi vendosen ndërmjet palëve.

15. PËRFUNDIMI

1. Duke respektuar paragrafin 2, kjo Marrëveshje do të përfundojë tetë vjet pas hyrjes në fuqi të saj. Ky përfundim nuk do të përjashtojë mundësinë që Komisioni të bëjë korrigjime financiare, në përputhje me nenin 56 të rregullores së zbatimit IPA.

2. Kjo Marrëveshje mund të përfundojë nga secila palë duke informuar me shkrim palën tjetër. Ky përfundim do të ketë efekt gjashtë muaj kalendarikë që nga data e njoftimit me shkrim.

16. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

1. Mosmarrëveshjet që dalin nga interpretimi, përdorimi dhe zbatimi i kësaj Marrëveshjeje, në secilën prej dhe të gjitha nivelet e pjesëmarrjes, do të rregullohen me mirëkuptim nëpërmjet konsultimit mes palëve.

2. Në mungesë të zgjidhjeve miqësore, secila nga palët mund ta çojë çështjen për gjykim në përputhje me Rregullat Fakultative të Gjykimit të Gjykatës së Përhershme për Arbitrazh, që lidhen me organizatat ndërkombëtare dhe shtetet në fuqi në datën e kësaj Marrëveshjeje.

3. Gjuha që do të përdoret në procedurat e gjykimit do të jetë gjuha angleze. Autoriteti i caktuar do të jetë Sekretari i Përgjithshëm i Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit, pas një kërkese me shkrim të dërguar nga cilado nga palët. Vendimi i arbitrit do të jetë i detyrueshëm për të gjitha palët dhe nuk do të ketë proces apelues.

17. NJOFTIME

1. Çdo komunikim, në lidhje me këtë Marrëveshje, do të bëhet në formë të shkruar dhe në gjuhën angleze. Çdo komunikim duhet të firmoset dhe duhet të dërgohet si një dokument zyrtar ose me faks.

2. Çdo komunikim, në lidhje me këtë Marrëveshje, duhet të dërgohet në adresat e mëposhtme:

Për Komunitetin:
z. Helmuth Lohan
Shef i Delegacionit
Delegacioni i Komisionit Europian në Shqipëri
Qendra e Biznesit “ABA”, kati i 17-të
Rr. “Papa Gjon Pali II”
Tiranë – Shqipëri
Fax: + 355 4230752

Për vendin përfitues
znj. Majlinda Bregu
Ministër i Integrimit Europian
Rr. “Papa Gjon Pali II”, nr. 3
Tiranë, Shqipëri
Fax +355 4256267

18. NUMRI I ORIGJINALEVE

Kjo Marrëveshje është hartuar në dy kopje në gjuhën angleze.

19. SHTOJCAT

Anekset A, B dhe C do të përbëjnë një pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

20. HYRJA në FUQI

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën e nënshkrimit të saj. Në rast se palët nënshkruajnë në ditë të ndryshme, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit nga pala e dytë.

Firmosur, për dhe në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës se Shqipërisë, në Tiranë në datë

nga .....
znj. Majlinda Bregu
Ministër i Integrimit Europian

Firmosur, për dhe në emër të Komisionit, në Tiranë në datë
nga .....
z. Helmuth Lohan
Shef i Delegacionit të Komisionit Europian

ANEKSI A
PROGRAMI I FINANCIMIT PËR PJESËMARRJEN E SHQIPËRISË NË PROGRAMET TRANSNACIONALE ERDF TË BASHKËPUNIMIT TERRITORIAL EUROPIAN “EUROPA JUGLINDORE” DHE ‘MESDHEU’, NËN KOMPONENTIN E BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR TË INSTRUMENTIT IPA PËR VITIN 2009

ANEKSI B
MARRËVESHJA KUADËR NDËRMJET KOMISIONIT TË KOMUNITETEVE EUROPIANE DHE KËSHILLIT TË MINISTARVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, DATË 18 TETOR 2007

ANEKSI C
RAPORTIMI

1. Struktura operuese përgjegjëse për pjesëmarrjen e vendit përfitues në programet transnacionale, duhet t’i dërgojë Komisionit dhe koordinatorit kombëtar IPA një raport vjetor dhe një raport përfundimtar mbi zbatimin e këtij programi.

Raporti vjetor duhet të dërgohet çdo vit brenda datës 30 qershor; raporti i parë në vitin e dytë që pason adaptimin e programit ndërkufitar.

Raporti përfundimtar duhet të dërgohet jo më vonë se 6 muaj pas mbylljes së këtij programi.

2. Raportet e referuara në paragrafin 1 duhet të përmbajnë informacionin e mëposhtëm:

a) Progresin e bërë gjatë pjesëmarrjes në programet transnacionale dhe prioritetet në raport me qëllimet e tyre specifike të verifikueshme, me një përcaktim sasior të tyre, kudo dhe kurdo që kjo të jetë e mundur, duke përdorur indikatorët në nenin 94 (1) (d) të rregullores së zbatimit IPA në nivel të akseve prioritare.

b) Hapat e ndërmarra nga struktura operuese për të siguruar cilësinë dhe efektivitetin e zbatimit, në veçanti:

- masat monitoruese dhe vlerësuese, duke përfshirë masat për mbledhjen e të dhënave,
- një përmbledhje të problemeve të rëndësishme të hasura në zbatimin e këtij programi dhe çdo mase të marrë;
- përdorimin e asistencës teknike.

c) Masat e marra për të siguruar informimin dhe publicitetin mbi këtë program.

Aty ku është e përshtatshme, informacioni i referuar në pikat (a) deri në (c) të këtij paragrafi mund të jepet në formë të përmbledhur.

Nuk është e nevojshme që informacioni i referuar në pikën (b) të përfshihet nëse nuk ka pasur një ndryshim të rëndësishëm që nga raporti i mëparshëm.

ANEKS
PROGRAMI I FINANCIMIT TË PJESËMARRJES SË SHQIPËRISË NË PROGRAMET TRANSNACIONALE TË BASHKËPUNIMIT TERRITORIAL EUROPIAN "EUROPA JUGLINDORE" DHE “MESDHEU’ NËN KOMPONENTIN IPA, BASHKËPUNIMI NDËRKUFITAR PËR VITIN 2009

1. Identifikimi

Përfituesi	Shqipëria
Numri CRIS	2009/
Viti	2009
Kosto	€ 600 202
Struktura operuese	Ministria e Integrimit Europian
Autoriteti zbatues	Komisioni Europian

Data përfundimtare për miratimin e marrëveshjes së financimit	Maksimumi brenda datës 31 dhjetor 2010
Data përfundimtare për nënshkrimin e kontratave	2 vjet nga data e hyrjes në fuqi të marrëveshjes së financimit. Nuk ka afat për projektet e auditimit dhe vlerësimit që mbulohen nga kjo marrëveshje financimi, duke iu referuar nenit 166(2) të rregullores financiare. Këto data vlejnë edhe për bashkëfinancimin kombëtar.
Data përfundimtare për zbatimin e Marrëveshjes	2 vjet nga data përfundimtare e nënshkrimit të kontratave. Këto data vlejnë edhe për bashkëfinancimin kombëtar.
Kodi i sektorit	41010, 21010, 43030, 99810,32182
Zëri buxhetor përkatës	22.02.04.01
Menaxheri përgjegjës i programimit	Drejtoria e Përgjithshme e Zgjerimit, Njësia C4
Menaxheri përgjegjës i zbatimit	Delegacioni i KE-së në Shqipëri, seksioni operacional

2. Programi

2.1 Hyrje

Qëllimi i këtij programi është të mbështesë financiarisht – nëpërmjet fondeve të vitit 2009 të komponentit IPA bashkëpunimi ndërkufitar – pjesëmarrjen e Shqipërisë në programet transnacionale ERDF "Europa Juglindore" dhe "Mesdheu" nën objektivin e bashkëpunimit territorial europian të fondeve strukturore 2007–2013.

Vendosja dhe zhvillimi i bashkëpunimit transnacional është një nga prioritetet e objektivit të Bashkëpunimit Territorial Europian të Fondeve Strukturore 2007–2013. Për këtë qëllim, territori i BE-së është ndarë në disa hapësira homogjene dhe vendet anëtare, pjesë e këtyre territoreve, janë ftuar të paraqesin një program operacional të bashkëpunimit transnacional – financuar nga Fondi Europian për Zhvillimin Rajonal (ERDF) – për hapësirën e dhënë.

Duke marrë në konsideratë përfshirjen e tyre gjeografike në këto dy hapësira homogjene – hapësira e Europës Juglindore dhe hapësira mesdhetare – vendet kandidate/kandidate potenciale janë ftuar të marrin pjesë në programet operacionale përkatëse. Hungaria (Europa Juglindore) dhe Franca (Hapësira mesdhetare) janë vendet ku ndodhen autoritetet menaxhuese. Autoritetet përgjegjëse të Shqipërisë kanë pranuar ftesën dhe kanë vendosur të marrin pjesë në programin "Europa Juglindore" (që nga viti 2007) dhe programin "Mesdheu" (që nga viti 2009) me mbështetjen financiare të komponentit IPA bashkëpunimi ndërkufitar për vitin 2009.

I gjithë territori i Shqipërisë përfiton nga këto programe.

2.2 Objektivi i programit

Objektivi i këtij programi është i dyfishtë:

- Të mbështesë pjesëmarrjen e partnerëve të vendeve kandidate/kandidate potenciale në aktivitetet e bashkëpunimit transnacional me partnerë nga vendet anëtare;

- Të familjarizojë vendet kandidate/kandidate potenciale me programet e bashkëpunimit territorial të fondeve strukturore të BE-së në funksion të implementimit të tyre pas aderimit të këtyre vendeve në BE.

2.3 Akset prioritare

Programet ERDF "Europa Juglindore" dhe "Mesdheu" kanë si qëllim vendosjen dhe zhvillimin e bashkëpunimit transnacional nëpërmjet financimit të rrjeteve dhe veprimeve që çojnë në një zhvillim të integruar territorial, duke u përqendruar fillimisht në fushat e mëposhtme:

a) Inovacioni: krijimi dhe zhvillimi i rrjeteve shkencore dhe teknologjike dhe rritja e kapaciteteve inovative rajonale në fushën e kërkimit dhe zhvillimit teknologjik (R&TD), të cilat kontribuojnë në mënyrë direkt në zhvillimin e balancuar ekonomik të zonës transnacionale. Aktivitetet mund të përfshijnë: krijimin e rrjeteve ndërmjet institucioneve të përshtatshme të arsimit dhe kërkimit terciar dhe SME-ve; krijimin e lidhjeve për të përmirësuar aksesin në dijet shkencore dhe transferimin e teknologjisë midis faciliteteve të kërkimit dhe zhvillimit teknologjik dhe qendrave ndërkombëtare të ekselencës në këto fusha; binjakëzimi i institucioneve të transferimit të teknologjisë; dhe zhvillimi i instrumenteve të përbashkëta të inxhinierisë financiare

me fokus tek mbështetja në fushën e kërkimit dhe zhvillimit teknologjik të SME-ve.

b) Mjedisi: aktivitete për menaxhimin e ujërave, përdorimin efiçent të energjisë, parandalimin e rreziqeve dhe mbrojtjen e mjedisit, me një dimension të qartë transnacional. Ato mund të përfshijnë: mbrojtjen dhe menaxhimin e baseneve ujore, zonave bregdetare, burimeve detare, shërbimeve ujore dhe tokave të lagura; parandalimi i zjarreve, thatësirës dhe përmbytjeve; promovimi i sigurisë detare dhe mbrojta ndaj rreziqeve natyrore dhe teknologjike; dhe mbrojtja dhe përmirësimi i trashëgimisë natyrore dhe kulturore në mbështetje të zhvillimit socio-ekonomik dhe turizmit të qëndrueshëm.

c) Aksesibiliteti: aktivitete për të përmirësuar aksesin në shërbime cilësore të transportit dhe telekomunikacionit, me një dimension të qartë transnacional. Ato mund të përfshijnë: investime në segmentet ndërkufitare të rrjeteve transeuropiane; përmirësimin e aksesit lokal dhe rajonal në rrjetet kombëtare dhe transnacionale; përmirësimin e ndërveprueshmërisë së sistemeve kombëtare dhe rajonale; dhe promovimin e teknologjive të avancuara në fushën e informimit dhe komunikimit.

d) Zhvillimi i qëndrueshëm urban: aktivitete për forcimin e zhvillimit policentrik në nivel transnacional, kombëtar dhe rajonal, me një dimension të qartë transnacional. Ato mund të përfshijnë: krijimin dhe përmirësimin e rrjeteve urbane dhe lidhjeve urbane-rurale; strategji për të trajtuar çështje të përbashkëta urbane-rurale; ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore dhe integrimi strategjik i zonave të zhvillimit.

Prioritetet duhet të implementohen kryesisht nëpërmjet ftesave unike për propozime që mbulojnë të gjithë territorin përfitues, duke përfshirë atë të vendeve kandidate/kandidate potenciale. Ftesa e parë për propozime pritet të publikohet në vitin 2008.

Kriteret thelbësore të përzgjedhjes së projekteve dhe dhënies së granteve janë parashtruar në programet transnacionale përkatëse ERDF. Kriteret e detajuara të përzgjedhjes së projekteve dhe dhënies së granteve do të përshkruhen në paketën e aplikimit të ftesës për propozime (Udhëzuesi për aplikuesit).

Deri në 10% të fondeve IPA të alokuara për pjesëmarrjen e Shqipërisë në programet "Europa Juglindore" dhe "Mesdheu", mund të përdoren për të bashkëfinancuar (deri në 85% të shpenzimeve të lejuara) kostot operacionale dhe administrative të shpenzuara nga autoritetet kombëtare gjatë implementimit të programeve.

Këto mund të përfshijnë, ndër të tjera, kostot e mëposhtme:

- mbështetje për strukturën operuese;
- shpenzimet për pjesëmarrjen në takime të ndryshme mbi implementimin e programit;
- kostot për pjesëmarrjen e stafit kombëtar në Sekretariatin e Përbashkët Teknik, me përjashtim të rrogave të zyrtarëve publikë dhe krijimin, sipas rastit, të antenës kombëtare të SPT-së ose pikat e informacionit;
- kostot administrative dhe operacionale, duke përfshirë kostot e përgatitjes, monitorimit dhe vlerësimit të programit dhe kostot për mbështetje për përgatitjen e projekteve, vlerësimin dhe përzgjedhjen e projekteve, organizimin e takimeve që lidhen me programin, përkthimin, informimin dhe publicitetin.

Qëllimi kryesor i kontributit IPA për këtë zë shpenzimesh është të lehtësojë administrimin dhe implementimin efektiv dhe efikas të këtyre programeve në Shqipëri.

Përfituesit kryesorë të fondeve të asistencës teknike do të jenë struktura operuese, Sekretariati i Përbashkët Teknik, (duke përfshirë edhe antenën apo pikën e informacionit), çdo strukturë/organ tjetër, të lidhura me zhvillimin dhe implementimin e këtij programi dhe përfituesit e programit.

Duke marrë në konsideratë faktin që autoritetet kombëtare përkatëse (Struktura operuese ose koordinatori CBC – sipas kuptimit të nenit 22(2)(b) të Rregullores së Implementimit IPA) gëzojnë një situatë monopoli *de facto* (sipas kuptimit të nenit 168, paragrafi 1, nënparagrafi c i rregullave të implementimit të rregullores financiare) për të menaxhuar pjesëmarrjen e Shqipërisë në programet "Europa Juglindore" dhe "Mesdheu", një marrëveshje granti e drejtpërdrejtë për

shumën e asistencës teknike të specifikuar në tabelën financiare në seksionin 3.1 pa një ftesë për propozime, duhet të nënshkruhet midis Komisionit (delegacionit të KE-së) dhe autoriteteve kombëtare përkatëse. Kjo marrëveshje granti direkt mund të nënshkruhet menjëherë, pasi marrëveshja e financimit që ka të bëjë me këtë program, të jetë nënshkruar. Aktivitetet që mbulohen nga marrëveshja e grantit të drejtpërdrejtë (p.sh. asistenca teknike, vlerësimi, publiciteti etj.) mund të prokurohen më tej nga ai që përfiton nga granti, në përputhje me nenin 120 të rregullores financiare[1] dhe nenit 184 të rregullores së zbatimit[2] të rregullores financiare.

2.4.Vështrim i shkurtër mbi eksperiencën e kaluar dhe në vazhdim në fushën e bashkëpunimit transnacional, duke përfshirë mësimet e nxjerra

Gjatë vitit 2004–2006, fondet CARDS u përdorën edhe për pjesëmarrjen e vendeve të Ballkanit Perëndimor në programin e fqinjësisë "Hapësira qendrore, adriatike, danubiane dhe juglindore" (CADSES), një nga zonat e bashkëpunimit europian transnacional për vitet 2000–2006 e mbuluar nga iniciativa INTERREG IIIB. Pjesëmarrja në programin CADSES, pararendësja e programit Europa Juglindore 2007–13, iu dha mundësinë e parë vendeve të Ballkanit Perëndimor të përfshihen në bashkëpunimin transnacional me vendet anëtare të BE-së dhe, në të njëjtën kohë, të familjarizohen me procedurat e programeve INTERREG.

Ndërsa programi CADSES u implementua nëpërmjet ftesave unike të përbashkëta për propozime, mësimet e nxjerra për pjesëmarrjen e vendeve kandidate/ kandidate potenciale janë si më poshtë:

- Autoritetet kombëtare duhet të alokojnë burimet njerëzore të mjaftueshme për të marrë pjesë në mënyrë aktive në strukturat e menaxhimit të programit (Komitetin e Përbashkët të Monitorimit, Komitetin e Përbashkët Drejtues/Vlerësues, Sekretariati i Përbashkët Teknik) dhe të ndjekin implementimin e programit/projekteve të vendeve të tyre. Një pjesë e vogël e fondeve të Komunitetit të alokuara për çdo vend kandidat/kandidat potencial duhet të jetë në dispozicion për të mbuluar kostot operacionale të lidhura me implementimin e programit.

- Koordinimi efektiv midis delegacionit të KE-së dhe vendit pjesëmarrës kandidat/ kandidat potencial (p.sh. në aprovimin *ex–ante* të ftesave unike për propozime përpara publikimit të tyre) dhe midis vendit pjesëmarrës dhe autoritetit menaxhues, është thelbësore për të siguruar një implementim sa më të lehtë dhe në kohë të programit.

2.5. Të dhëna

("N" është data e hyrjes në fuqi të marrëveshjes së financimit)

	N* (2009)	N+1 (kumulative)	N+2 (kumulative)
Numri i ftesave për propozime të bëra	1		
Norma e kontraktimit (%)		100%	
Numri i marrëveshjeve të granteve të drejtpërdrejta (fondet AT)	1		

* N është data e nënshkrimit të marrëveshjes së financimit.

2.6. Hapat për decentralizimin e menaxhimit të fondeve të BE-së pa kontrollet *ex ante*

[1] Rregullorja (KE, Euroatom) nr. 1605/2002 (GZ L 248, 16/09/2002, faqe 1)

[2] Rregullorja (KE, Euroatom) nr. 2342/2002 (GZ L 357, 31/12/2002, faqe 1)

nga Komisioni

Në përputhje me nenin 8(4)c) të rregullores së zbatimit IPA, vendet përfituese duhet të përcaktojnë hapat me të dhëna indikative dhe afatet kohore për arritjen e decentralizimit pa kontrollet *ex-ante* nga ana e Komisionit.

Në Shqipëri, Këshilli i Ministrave miratoi në shtator 2007 një vendim për ngritjen e strukturave, autoriteteve dhe përcaktimin e përgjegjësive për implementimin e IPA-s sipas Sistemit të Decentralizuar të Implementimit (DIS). Në nëntor 2007, Ministria e Financave i paraqiti Drejtorisë së Përgjithshme të Zgjerimit një propozim për funksionimin e Njësisë Qendrore të Financimit dhe Kontraktimit (CFCU), e cila dha komentet dhe këshillat e saj në lidhje me këtë propozim. Një projekt asistence teknike nën IPA 2007 ka filluar. Kontrata e shërbimeve pritet të përfundojë brenda datës 19 dhjetor 2008 dhe aktivitetet të fillojnë në datë 15 janar 2009. Planifikimi indikativ i aktiviteteve të propozuara nga konsulenti i kontraktuar, mund të ndahen në 2 faza: në fazën e parë, me kohëzgjatje një vit, konsulenti do t'i mbështesë autoritetet shqiptare në rishikimin, përgatitjen dhe zhvillimin e të gjitha aktiviteteve që kërkohen për të përfunduar me sukses fazat 1 dhe 2 më sipër; gjatë fazës së dytë, me kohëzgjatje 6 muaj, konsulenti do të testojë strukturat e zhvilluara dhe përputhjen e tyre me kërkesat IPA DIS, dhe do të zhvillojë trajnime.

3. Buxheti për vitin 2009

3.1. Tabela financiare indikative 2009

	Kontributi i Komunitetit – IPA		Kontributi kombëtar		Totali (IPA plus kontributin kombëtar)	
	EUR. (a)	% (1)	EUR. (b)	(%)(1)	EUR. (c)=(a)+(b)	(%)(2)
Pjesëmarrja në programin transnacional "Europa Juglindore"	360 182	85	63 562	15	423 744	60
Pjesëmarrja në programin transnacional "Mesdheu"	180 000	85	31 765	15	211 765	30
Fondet e AT	60 020	85	10 591	15	70 611	10
TOTAL	600 202	85	105 918	15	706 120	100

1. Shprehur në % të totalit (IPA plus kontributin kombëtar).

2. Shprehur në % të totalit të madh (c). Tregon peshën relative të çdo prioriteti duke iu referuar fondeve totale (IPA + kombëtare).

3.2. Parimi i bashkëfinancimit të projekteve të financuara nga programi

Kontributi i Komunitetit është llogaritur në raport me shpenzimet e lejuara, që në rastin e këtij programi, është bazuar në shpenzimet totale.

4. Plani i implementimit

4.1. Hyrje

Ky program i siguron Shqipërisë, nëpërmjet fondeve të komponentit II të IPA-s, financimin e pjesëmarrjes së partnerëve të saj kombëtarë në projekte të bashkëpunimit transnacional në kuadër të programeve transnacionale "Europa Juglindore" dhe "Mesdheu".

Hapat kryesore të implementimit do të jenë si më poshtë:

a) Autoritetet përgjegjëse të Shqipërisë do të përcaktojnë një strukturë operuese, e cila do të merret me menaxhimin dhe implementimin e këtij programi. Struktura operuese do të bashkëpunojë me autoritetin menaxhues të programeve "Europa Juglindore" dhe "Mesdheu" dhe do të përfaqësohet në komitetet e përbashkëta të monitorimit të këtyre programeve si anëtare me

të drejta të plota.

b) Komitetet e përbashkëta të monitorimit të programeve të mësipërme transnacionale do të përgatisin ftesat për propozime– paketat e aplikuesit (udhëzuesi për aplikuesit) për implementimin e programeve.

c) Përpara se të publikohet, njoftimi i ftesave për propozime dhe paketat e aplikuesve do të dërgohen në delegacionet e KE-së të vendeve kandidate/kandidate potenciale pjesëmarrëse në programet transnacionale, për aprovim *ex–ante*.

d) Për të përfituar nga financimi IPA, aktivitetet e përbashkëta duhet të përfshijnë përfitues edhe nga vendet anëtare, edhe nga vendet IPA. Aplikimet për aktivitete të përbashkëta duhet të identifikojnë një partner udhëheqës financiar me vendndodhje në një nga vendet anëtare për pjesën e aktiviteteve të përbashkëta që zhvillohen në territorin e BE-së me fonde ERDF, dhe nga një partner udhëheqës financiar në secilin prej vendeve kandidate/ kandidate potenciale pjesëmarrëse, për pjesën e aktiviteteve të përbashkëta që zhvillohen në këto vende dhe që financohen nga fondet IPA. Aplikimet duhet të bëjnë një ndarje të qartë midis aktiviteteve – dhe kostove të tyre – që zhvillohen në territorin e BE-së me fonde ERDF dhe ato që zhvillohen në këto vende dhe që financohen nga fondet IPA.

e) Komitetet e përbashkëta të monitorimit të programeve të mësipërme transnacionale janë përgjegjëse për përzgjedhjen e aktiviteteve të përbashkëta, në përputhje me rregullat e fondeve strukturore.

f) Raporti i vlerësimit dhe lista e projekteve të përzgjedhura për financim do t'i dërgohet delegacionit të KE-së për aprovim. Ky aprovim do të lidhet vetëm me pjesëmarrjen e partnerëve shqiptarë në projektet e përbashkëta përkatëse.

g) Delegacioni i KE-së në Shqipëri do t'ua alokojë grantet IPA partnerëve udhëheqës kombëtarë të cilët marrin pjesë në projektet e përbashkëta të përzgjedhura (ndërsa autoritetet menaxhuese të programeve "Europa Juglindore" dhe "Mesdheu" do t'ua alokojnë grantet ERDF partnerëve udhëheqës për pjesën e aktiviteteve të përbashkëta që zhvillohen në territorin e BE-së).

4.2 .Metoda e implementimit

Ky program do të implementohet në mënyrë të centralizuar nga Komisioni Europian në përputhje me nenin 53a të rregullores financiare[3] dhe dispozitave korresponduese të rregullave të implementimit[4].

Në rastin e menaxhimit të centralizuar, Komisioni:

- do të aprovojë ftesat për propozime dhe paketat e aplikuesve (udhëzuesin e aplikuesit) të hartuar nga strukturat e përbashkëta të menaxhimit të programeve transnacionale "Europa Juglindore" dhe "Mesdheu" përpara publikimit të tyre;
- do të konfirmojë formalisht projektet e përzgjedhura nga strukturat e përbashkëta të menaxhimit të programeve transnacionale "Europa Juglindore" dhe "Mesdheu" në të cilat marrin pjesë përfitues nga Shqipëria;
- do të ruajë, në të gjitha rastet, të drejtën për t'i alokuar grantin përfituesit udhëheqës nga Shqipëria, pjesëmarrës në projektin e përbashkët.

4.3. Rregullat e përgjithshme për procedurat e prokurimit dhe dhënies së granteve

Prokurimi duhet të zbatojë dispozitat e pjesës II, titulli IV të rregullores financiare dhe pjesës II, titulli III, kapitulli 3 i rregullave të implementimit[5], si dhe rregullat dhe procedurat për kontratat e shërbimeve, pajisjet dhe punimet të financuara nga buxheti i përgjithshëm i Komuniteteve Europiane për qëllime bashkëpunimi me vendet e treta, adoptuar nga Komisioni në datë 24 maj 2007 (C(2007)2034).

Procedurat e dhënies së grantit duhet të ndjekin dispozitat e pjesës I, titulli VI të rregullores financiare dhe pjesës I, titulli VI të rregullave të tij të implementimit.

---

[3] Shiko shënimin 1 më sipër
[4] Shiko shënimin 2 më sipër
[5] Shih shënimin 1 dhe 2 më sipër

Sipas rastit, autoriteti kontraktues do të përdorë gjithashtu formatin standard dhe modelet që lehtësojnë aplikimin e rregullave të mësipërme të cilat ndodhen në "Udhëzuesin praktik të procedurave të kontraktimit për veprimet e huaja të KE-së" ("Udhëzuesi praktik") publikuar në faqen e internetit të EuropeAid[6] në datën e fillimit të procedurave të prokurimit ose dhënies së granteve.

4.4. Vlerësimi i ndikimit mjedisor (EIA) dhe ruajtja e natyrës

Të gjitha investimet duhet të bëhen në përputhje me legjislacionin komunitar mjedisor.

Procedurat për vlerësimin e ndikimit mjedisor parashikuar në direktivën[7] EIA aplikohen plotësisht në të gjitha projektet e investimeve nën instrumentin IPA. Nëse direktiva EIA nuk është transpozuar plotësisht, procedurat duhet të jenë të ngjashme me ato të vendosura në këtë direktivë.

Nëse një projekt ka të ngjarë të ketë ndikim në vendet me rëndësi për ruajtjen e natyrës, një vlerësim i saktë i ruajtjes së natyrës duhet të bëhet, ekuivalente me atë të nenit 6 të Direktivës së Habitatit, dhe duhet të dokumentohet[8].

5. Monitorimi dhe vlerësimi

5.1. Monitorimi

Në Shqipëri, Komisioni mund të ndërmarrë çdo veprim që ai e konsideron si të nevojshëm për të monitoruar programin në fjalë.

5.2. Vlerësimi

Programet transnacionale ERDF janë subjekt i vlerësimit në përputhje me Rregulloren e Fondeve Strukturore (EC) nr.1083/2006, nën përgjegjësinë e autoritetit menaxhues të vendosur në një nga vendet anëtare pjesëmarrëse. Kur një vlerësim i tillë është bërë, çdo përpjekje duhet të bëhet për të vlerësuar gjithashtu elementet që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen e vendeve kandidate/kandidate potenciale në programet transnacionale.

Ky program do të jetë subjekt i vlerësimeve, në përputhje me nenin 57 dhe 82 të rregullores së implementimit IPA, me qëllim përmirësimin e cilësisë, efektivitetit dhe konsistencës së asistencës nga fondet e Komunitetit dhe strategjisë dhe implementimit të programit.

Komisioni mund të zhvillojë gjithashtu edhe vlerësime strategjike.

6. Auditimi, kontrolli financiar dhe masat antimashtrim

Llogaritë dhe aktivitetet e të gjitha palëve të përfshira në implementimin e këtij programi, si dhe të gjitha kontratat dhe marrëveshjet që implementojnë këtë program, janë subjekt, nga njëra anë, i mbikëqyrjes dhe kontrollit financiar të Komisionit (duke përfshirë edhe Zyrën Europiane të Anti-mashtrimit), i cili mund të zhvillojnë kontrolle, kur e gjykon të arsyeshme, ose vetë ose nëpërmjet një audituesi të jashtëm, nga ana tjetër, audituesve të Gjykatës Europiane të Llogarive. Kjo përfshin masa të tilla si p.sh. verifikimin *ex-ante* të tenderimeve dhe kontraktimeve të zhvilluara nga delegacionet e vendeve përfituese.

Me qëllim sigurimin e një mbrojtjeje efikase të interesave financiarë të Komunitetit,

---

[6] Adresa: http://ec.europa.eu/europeaid/work/procedures/implementation/practical_guide/index_en.htm

[7] Direktiva e Këshillit 85/337/EEC e datës 27 qershor 1985 mbi vlerësimin e efekteve të disa projekteve publike dhe private mbi mjedisin (OJ L 175, 5.7.1985, fq. 40. Direktive e amenduar se fundmi nga Direktiva 2003/35/EC, OJ L 156, 25.6.2003, fq. 17.

[8] Direktiva e Këshillit 92/43/EEC të datës 21 maj 1992 mbi ruajtjen e habitatit natyror dhe florës dhe faunës se egër (OJ L206, 22.7.1992). Direktive e amenduar se fundmi nga rregullorja (EC) nr. 1882/2003 (OJ L284, 31.10.2003, fq. 1)

Komisioni (duke përfshirë dhe Zyrën Europiane të Antimashtrimit) mund të zhvillojnë kontrolle në vend dhe inspektime, në përputhje me procedurat e parashikuara në Rregulloren e Këshillit (EC, Euratom) 2185/96[9].

Kontrollet dhe auditimet e përshkruara më lart aplikohen për të gjithë kontraktuesit, nënkontraktuesit dhe përfituesit e grantit që kanë përfituar fonde nga Komuniteti.

7.Ndryshime të kufizuara

Ndryshime të kufizuara në implementimin e këtij programi që kanë ndikim mbi elementet thelbësore të listuara në nenin 90 të rregullave të implementimit të rregullores financiare, e cila është e një natyre indikative[10], mund të ndërmerren nga zyrtari autorizues i Komisionit me anë të delegimit (AOD), ose nga zyrtari autorizues i Komisionit me anë të nëndelegimit(AOSD), në përputhje me pushtetin e deleguar nga ana e AOD, në përputhje me parimet e menaxhimit të mirë financiar, pa qenë i nevojshëm një vendim ndryshimi financiar.

VENDIM I KOMISIONIT

C(2009) 6503 i datës 25 gusht 2009

PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË PJESËMARRJES SË SHQIPËRISË NË PROGRAMET TRANSNACIONALE ERDF TË BASHKËPUNIMIT TERRITORIAL EUROPIAN "EUROPA JUGLINDORE" DHE "MESDHEU" NËN KOMPONENTIN E BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR IPA, PËR VITIN 2009

Komisioni i Komuniteteve Europiane,

duke pasur parasysh traktatin themelues të Komunitetit Europian,

duke pasur parasysh Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 1085/2006 të datës 17 korrik 2006 që krijon Instrumentin e Ndihmës së Paraaderimit (IPA)[11] dhe veçanërisht nenin 14, pika 2, shkronja (a) të saj,

meqë:

1. Rregullorja (KE) nr. 1085/2006 përcakton objektivat dhe parimet kryesore për asistencën e paraaderimit për vendet kandidate dhe kandidate potenciale.

2. Në përputhje me nenin 7, pika 1 të Rregullores së Këshillit (KE) nr. 1085/2006, asistenca duhet të jepet nëpërmjet programeve vjetore ose shumëvjeçare, për vend, grup vendesh ose komponentë. Këto programe duhet të hartohen në përputhje me kuadrin e përgjithshëm të politikës, siç përcaktohet në nenin 4 të rregullores nr. 1085/2006 dhe dokumentet planifikuese indikative shumëvjeçare relevante të referuara në nenin 6 të kësaj rregulloreje.

3. Këshilli ka vendosur një partneritet europian për Shqipërinë[12]. Në datë 29 shtator 2008, Komisioni miratoi Dokumentin Planifikues Indikativ Shumëvjeçare 2008-2010 për Shqipërinë, i cili përmbledh prioritetet kryesore për ndihmën e paraaderimit për këtë vend[13].

4. Në përputhje me nenin 9 të Rregullores (KE) nr. 1085/2006 dhe siç parashikohet në nenin 86(4) të Rregullores së Komisionit (KE) nr. 718/2007 të datës 12 qershor 2007 që zbaton Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 1085/2006, e cila krijon Instrumentin e Ndihmës së Paraaderimit (IPA)[14], (këtej e tutje referuar "Rregullorja e zbatimit IPA"), komponenti i bashkëpunimit ndërkufitar IPA mund të mbështesë gjithashtu, sipas rastit, pjesëmarrjen e zonave përfituese të vendit përfitues në programe transnacionale nën objektivin bashkëpunimi territorial europian i fondeve strukturore.

---

[9] Rregullorja e Këshillit (EC,Euratom) 2185/96 e datës 11 nëntor 1996, OJ L 292; 15.11.1996; fq. 2.

[10] Këto elemente thelbësore të natyrës indikative janë shuma indikative e ftesës për propozime dhe, për prokurimet, numri indikativ, lloji i kontratave i parashikuar dhe itinerari indikativ për fillimin e procedurave të prokurimit.

[11] GZ L 210, 31.7.2006, faqe 82

[12] Vendim i Këshillit 2008/210/KE i datës 18 shkurt 2008, GZ L 80, 19.3.2006, faqe 1-17

[13] C(2008)XXXX

[14] GZ L 170, 29.6.2007, faqe 1

5. Duke pasur parasysh interesin e shprehur nga autoritetet kombëtare përgjegjëse, për vitin 2009, komponenti i bashkëpunimit ndërkufitar IPA do të financojë pjesëmarrjen e Shqipërisë në programet transnacionale ERDF-bashkëpunimi territorial europian "Europa Juglindore" dhe "Mesdheu". Këto programe kanë si qëllim të mbështesin krijimin dhe zhvillimin e bashkëpunimit transnacional nëpërmjet financimit të rrjeteve dhe aktiviteteve që çojnë në një zhvillim të integruar territorial, duke u përqendruar fillimisht në fushat e mëposhtme prioritare: inovacioni, mjedisi, aksesi, zhvillimi i qëndrueshëm urban.

6. Ky vendim plotëson kërkesat e nenit 90 të Rregullores së Komisionit (KE, Euroatom) nr. 2342/2002 të datës 23 dhjetor 2002, e cila përcakton rregullat e detajuara për implementimin e Rregullores së Këshillit nr.1605/2002[15] duke qenë kështu një vendim financimi sipas kuptimit të nenit 75(2) të Rregullores së Këshillit nr.1605/2002 të datës 25 qershor 2002 të rregullores financiare të aplikuar për buxhetin e përgjithshëm të Komuniteteve Europiane [16].

7. Masat e parashikuara në këtë vendim janë në përputhje me opinion e Komitetit IPA,

vendosi si më poshtë:

Neni 1

Miratohet programi për financimin e pjesëmarrjes së Shqipërisë në programet transnacionale ERDF të bashkëpunimit territorial europian "Europa Juglindore" dhe "Mesdheu" nën komponentin e bashkëpunimit ndërkufitar IPA, për vitin 2009, siç përcaktohet në aneks.

Ky program do të zbatohet në mënyrë të centralizuar.

Ai do të zbatohet nëpërmjet marrëveshjes së financimit që do të nënshkruhet midis Komisionit dhe Këshillit të Ministrave të Shqipërisë, në përputhje me marrëveshjen kuadër të nënshkruar midis të njëjta palëve më datë 18 tetor 2007.

Neni 2

Shuma maksimale e kontributit të Komunitetit do të jetë 600 202 euro, dhënë nga zëri 22.020401 i buxhetit të përgjithshëm të Komuniteteve Europiane për vitin 2009.

Nënshkruar në Bruksel,

Për Komisionin
Anëtar i Komisionit

[15] GZ L 357, 31.12.2002, faqe 1
[16] GZ L 248, 16.9.2002, faqe 1